



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

SHPALLJE PËR NËPUNËS CIVIL,
LËVIZJE PARALELE DHE PRANIMIN
NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE
(Sektori i Financës dhe Buxheti në Këshillin e Qarkut Korçë)

Në zbatim të neneve 22 dhe 25 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe të Kreut II, IV dhe VII të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive", i ndryshuar, Këshilli i Qarkut Korçë shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimin në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për pozicionin:

1 (një) Specialist për Financën dhe Buxhetin në Sektorin e Financës dhe Buxhetit, kategoria IV

Pozicioni më sipër u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele në shërbimin civil!

Vetëm në rast se ky pozicion, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton vakant, atëherë është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimin në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë.

Afati i dorëzimit të dokumentave për **lëvizje paralele** është: **07.09.2025**

Afati i dorëzimit të dokumentave për **pranim në shërbimin civil**: **14.09.2025**

Përshkrimi i përgjithshëm i punës:

- Ndjek fondin e planifikuar të pagave dhe sigurimeve shoqërore për punonjësit e administratës dhe për funksionet e deleguara; përgatit listë-pagesat mujore të punonjësve të administratës në bazë të urdhrave përkatës të titullarit të institucionit.
- Përgatit evidencën me të dhënat për sigurimet shoqërore dhe tatimin mbi të ardhurat për çdo muaj për punonjësit; i dërgon online në Degën e Tatim-Taksave. Gjithashtu, përgatit evidencën për sigurimin suplementar dhe e dërgon pranë organit përkatës të Sigurimeve Shoqërore.
- Përpilon dokumentacionin financiar (si urdhër-shpenzime etj.) për realizimin e shpenzimeve sipas fondeve për çdo strukturë të miratuar, bazuar në dokumentacionin paraprak, dhe ndjek procedurat e kalimit të tyre me Degën e Thesarit.
- Harton situacionin progresiv të shpenzimeve dhe e rakordon çdo muaj me Degën e Thesarit.
- Ndjek në mënyrë kronologjike, regjistron dhe kontabilizon urdhër-shpenzimet e ekzekutuara, duke i rakorduar me situacionin e shpenzimeve të konfirmuara nga Thesari.
- Plotëson në mënyrë të vazhdueshme librin e të ardhurave të Këshillit të Qarkut dhe çdo muaj kryen

rakordimin me Degën e Thesarit.

- Përgatit faturat për arkëtim në të gjitha fushat dhe referencat, sipas formatit të miratuar nga Ministria e Financave, për kontributin e bashkive, bazuar në titullin për arkëtim.
- Regjistron në ditar dhe kontabilizon veprimet e hyrje - daljeve në magazinë. Çdo muaj rakordon gjendjen fizike të materialeve në magazinë dhe mban kartelën për secilin artikull të magazinës.
- Bën llogaritjet e konsumit të karburantit për automjetet e institucionit në bazë të normativave të miratuara, dhe nxjerr rezultatet çdo muaj.
- Përditëson inventarizimin e zyrave dhe i paraqet komisionit të inventarizimit gjendjen kontabël të inventarit.
- Kryen çdo veprim arkëtimi për të gjitha të ardhurat që realizon institucioni; përpunon pagesat e ndryshme nga arka, furnizon personat përgjegjës të ZAMT-ve në rrethe me fatura arkëtimi dhe kryen derdhjen e të gjitha të ardhurave në Thesar nëpërmjet bankave.

1. LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori ekzekutive, në të gjithë institucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a. Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (ekzekutive);
- b. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c. Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mire”;
- d. Të plotësojë kriteret e veçanta për konkurrim.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Financë Kontabilitet ose të barasvlefshme me të, edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- b- Të kenë të paktën 3 vjet përvojë pune në profesion.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë njësisë së burimeve njerëzore në Këshillin e Qarkut Korçë dokumentet si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
- b- Fotokopje e noterizuar e diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f- Vërtetim të gjendjes gjyqësore;

- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Aktin e emërimit në shërbimin civil;
- i- Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- j- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton mesataren e ponderuar të diplomës (listë notash, vërtetim nga fakulteti), trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- k- Një letër interesi për pozicionin vakant që dëshironi të konkuroni.

Dokumentat duhet të dërgohen me postë ose të dorëzohen në institucionin e Këshillit të Qarkut Korçë, brenda datës **07.09.2025**, në adresë: Lagjia 7, Rruga "28 Nëntori", Korçë 7001, Shqipëri.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **08.09.2025** Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Këshillit të Qarkut Korçë ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" dhe në faqen zyrtare të institucionit listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

1.4 FUSHA E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA.

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

1. Njohuritë mbi ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore"
2. Njohuritë mbi ligjin nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore"
3. Njohuritë mbi ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar
4. Njohuritë mbi udhëzimin nr. 2, datë 06.02.2012, të Ministrisë së Financave, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar
5. Njohuritë mbi ligjin nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar
6. Njohuritë mbi VKM nr. 929, datë 17.11.2010, "Për fondin e veçantë", i ndryshuar
7. Njohuritë mbi ligjin nr. 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025"
8. Njohuritë mbi udhëzimin plotësues nr. 2, datë 24.01.2025, "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025"
9. Njohuritë mbi udhëzimin nr. 35, datë 29.12.2023, "Për procedurat për menaxhimin e vështirësive financiare për NJVQV-të"
10. Njohuritë mbi udhëzimin nr. 37, datë 06.10.2020, "Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme"
11. Njohuritë mbi udhëzimin nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore (NJQV)"
12. Njohuritë mbi udhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar
13. Njohuritë mbi ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar
14. Njohuritë mbi ligjin nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"
15. Njohuritë mbi ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike", i ndryshuar

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE PËR LËVIZJEN PARALELE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të institucionit Këshilli i Qarkut Korçë.

2. PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se pozicioni i shpallur është ende vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimin në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive. Këtë informacion do ta merrni në faqen e Këshillit të Qarkut Korçë, duke filluar nga data 08.09.2025

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimin në shërbimin civil janë:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Financë Kontabilitet ose të barasvlefshme me të. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- Të kenë të paktën 1 vit përvojë pune në profesion.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor). Për diplomat e marra jashtë republikës së shqipërisë të përcillet njehsimi nga ministria e arsimit dhe e sportit;
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton mesataren e ponderuar të diplomës (listë notash, vërtetim nga fakulteti), trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- Një letër ku shprehet interesi për aplikim për pozicionin vakant.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, bëhet pranë njësisë së Burimeve Njerëzore në Këshillin e Qarkut Korçë, ose nëpërmjet shërbimit postar.

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive duhet të bëhet brenda datës **14.09.2025**.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **15.09.2025**, Këshilli i Qarkut Korçë, do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “shërbimi kombëtar i punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga institucioni, për shkaqet e moskualifikimit (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”
- Njohuritë mbi ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar
- Njohuritë mbi ligjin nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”
- Njohuritë mbi udhëzimin plotësues nr. 2, datë 24.01.2025, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”
- Njohuritë mbi udhëzimin nr. 35, datë 29.12.2023, “Për procedurat për menaxhimin e vështirësive financiare për NJVQV-të”
- Njohuritë mbi udhëzimin nr. 37, datë 06.10.2020, “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”
- Njohuritë mbi udhëzimin nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të NJQV”

- Njohuritë mbi udhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njërive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar
- Njohuritë mbi ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar
- Njohuritë mbi ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
- Njohuritë mbi ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”
- Njohuritë mbi ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, i ndryshuar

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës për pozicionet;
- eksperiencën e tyre të mëparshme
- motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të departamentit të administratës publike www.dap.gov.al

<http://www.dap.gov.al/legislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Këshilli i Qarkut Korçë do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “shërbimi kombëtar i punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen zyrtare të Këshillit të Qarkut Korçë, për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimit në shërbimin civil të kategorisë ekzekutive

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Këshillit të Qarkut Korçë (<https://qarkukorce.gov.al>), duke filluar nga data **15.09.2025**